



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 72/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Rruga “Kasëm Haxhimurati”, p.n, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. 1104-2019 i datës 19.09.2019, për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës, të disa personave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datën 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 22.09.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** i palejuar apeli Anr.72/2019 i datës 20.09.2019, i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Rruga “Kasëm Haxhimurati”, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. 1104-2019 i datës 19.09.2019.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 20.09.2019, ka pranuar apelin nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, me nr.1104-209 i datës 19.09.2019, lidhur me mos përfshirjen e 64 personave, për të marrë pjese në programin votues jashtë Kosovës në Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019. Parashtruesi i apelit, kërkon nga PZAP-i, që ta udhëzon KQZ-në, që ta rishqyrtoj vendimin e apeluar, dhe personat e paraqitur në tabelë, t'i përfshij në listën votueseve jashtë Kosove.

PZAP-i, pasi shqyrtoi lejueshmërinë e apelit, gjeti se apeli i paraqitur është i palejuar, për arsye se:

Nga shkresat e lëndës rezulton se paraqitësi i apelit, në PZAP, me datë 20.09.2019, ka paraqitur apelin kundër vendimit të KQZ-së, me Nr. 1104-2019 i datës 19.09.2019, sepse me rastin e Certifikimit të Listës Përfundimtare të Votuesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, nuk i ka pranuar edhe 64 votues, si votues jashtë Kosove.

Paneli, me rastin e shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit, gjeti se apeli është paraqitur nga subjekti politik, i cili nuk është subjekt i autorizuar apo subjekt që mund të paraqet apel, në emër të aplikuësve për t'u regjistruar si votues jashtë Kosove, për arsye:

Me nenin 97 paragrafi 1 i LZP-së, përcaktohet se: “Votuesi me të drejtë vote mund të aplikojë për të marrë një fletëvotim për Votim Jashtë Kosovës duke dorëzuar të plotësuar

*Aplikimin për Votim Jashtë Kosovës/Formularin e Regjistrimit të Votuesit ("Aplikimi Përmes-Postës") në formën në dispozicion nga faqja elektronike e KQZ-së:*

- a) përmes postës në një nga Kutitë Z.P të KQZ-së; ose
- b) përmes faksit në KQZ në numrin e shënuar në Aplikimin për Votim Jashtë Kosovës".

Me nenin 97 paragrafi 2 i LZP-së, përcaktohet se: "Votuesi me të drejtë vote i cili nuk është regjistruar paraprakisht për të votuar në zgjedhje nën autoritetin e KQZ-së duhet të dorëzojë, bashkë me Aplikimin për Votim Jashtë Kosovës të plotësuar, dokumentacion provë që ai ose ajo plotëson kriterin juridik të përcaktuar me nenin 5 të këtij ligji".

Me nenin 98 paragrafi 1 i LZP-së, përcaktohet se: "KQZ-ja, e njofton secilin kandidat nëse aplikimi i tij/saj, është pranuar apo refuzuar", ndërsa me paragrafin 2, të këtij neni përcaktohet se: "Çdo aplikues i cili është refuzuar ka të drejtë ankese ndaj këtij vendimi në PZAP".

Me nenin 122 paragrafi 1 LZP-së, përcaktohet se: "Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilido vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në PZAP, ndërsa me pikën a), është përcaktuar se: "Përfshirjen ose largimin e një personi për të marrë pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës".

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, paneli erdhi në përfundim se apeli i parashtruar duhet të hudhet si i palejuar, për arsye se e drejta për aplikim është individuale, siç është individuale për secilin votues njoftimi me vendim nga KQZ-ja, për rezultatin e aplikimit, ashtu është individuale edhe paraqitja e apelit, ndaj vendimit të KQZ-së, në PZAP, në rastet kur i refuzohet aplikimi, siç pretendohet që është në këtë rast, andaj nga kjo del se paraqitësi i apelit nuk e ka pas asnjë të drejtë ligjore, të paraqet apel në emër të 64 aplikuesve, për votues jashtë Kosove, respektivisht i njëjti nuk është subjekt i autorizuar për paraqitjen e apelit në fjalë.

Nga arsyet e theksuara me lart e duke u bazuara nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, dhe nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi, si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 72/2019 më datën 22.09.2019



#### ***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragraf 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.